“Pastaj Nuhu iu lut Zotit dhe i tha: O Zoti im, biri im është nga familja ime, premtimi Yt është i vërtetë dhe Ti je Gjykatësi më i drejtë!” (Hud, 45)

“Ky është rrëfim për mëshirën e Zotit tënd ndaj robit të Tij - Zekerijas. Kur ai e thirri Zotin e vet me lutje të fshehtë” (Merjem, 2-3)

“(Kujtoje) Zekerijan, kur iu lut Zotit të vet: “O Zoti im, mos më lër vetëm (pa fëmijë), e Ti je trashëgimtari më i mirë.” (Enbija, 89)

“(Kujtoje) Nuhun kur ai Na thirri më përpara, dhe Ne iu përgjigjëm atij, duke e shpëtuar atë dhe familjen e tij nga mjerimi i madh (mbytja).” (Enbija, 76)

“Kur Nuhu Na thirri (në ndihmë), Ne iu përgjigjëm bukur.” (Saffat, 75)

“Kujtoje robin Tonë Ejubin, kur iu lut Zotit të vet: “Me të vërtetë, më ka goditur djalli me mundim dhe vuajtje!” (Sad, 41)

“(Kujtoje) Ejubin, kur iu lut Zotit të vet: “Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!” (Enbija, 83)

“(Kujtoje) Dhun-Nunin (Junusin) kur iku i zemëruar e mendoi se Ne nuk do ta dënojmë, andaj thërriti nga errësira: “S’ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!” (Enbija, 87)

“Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd dhe mos u bëj si Njeriu i Peshkut (Junusi a.s.), kur iu lut Zotit të vet i dëshpëruar (në barkun e balenës)!” (Kalem, 47)

(Çka kupton me) “Thirrje”: të thërret gjuha e zemrës më zërin më të lartë nga thellësia e zemrës, duke kërkuar ndihmë, duke kërkuar mbështetje, duke kërkuar mbrojtje, kështu robi duke iu lutur Zoti me zemër të shqetësuar, me gjuhë të qetësuar dhe me edukatë sheriatike..
Kur e pyetën sahabet: O i dërguar i Allahut Zoti a është afër ti lutemi Atij, apo larg ta thërrasim Atë?
Muhamedi sal-Allahu alejhi ve selem ka thënë: “Vërtetë ju po luteni Atij që dëgjon dhe është afër,” (Shënon Muslimi)
Thirr:
O Zot.. O Allah..
O Zotëriu im..
O Ndihmëtari im..
O Mëshira ime..
O Ti i cili i përgjigjesh lutjes të shtypurit..

“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Sa pak që reflektoni!” (Nemël, 62)

Thuaj: LA I LAHE IL-LALLAH. LA I LAHE IL-LALLAH.

Phoca PDF

Thirr: O Allah.. Robër si unë janë të shumtë, për mua nuk është askush përveç Teje..
Thirr: O Allah.. Allahu im! Ti e dëgjon fjalën time, e sheh pozitën time, e din fshehtësinë time, asgjë e fshehur për Ty nuk është. Unë jam ai i cili kam nevojë për ndihmë Tënde, jam i varfër, jam nevojtarë, kam nevojë për mbrojtje Tënde, pranoj gjynahet që kam bërë. Andaj të lutem me lutjen e nevojtarit, të përgjërohem si pendimtarë i përulur.. Të lutem me lutjen e të frikuarit që ka shtrirë qafën e tij, e sytë janë mbushur me lot:
Allahu im! Me lutjen që Ty ta bëj, mos më bë të pafat, bëhu ndaj meje vazhdimisht Mëshirues.
Thirr: o Allah. Dituria Juaj mbi gjendjen time të mjafton nga pyetja ime. Nëse ndërpritet fjala ime, te Ti nuk ndërpritet shpresa im.
Nëse të ngushtohet ty dynjaja, e të kanë rrethuar gajlet, dertet, pikëllimet, janë rritur sprovat e problemet, thirr: O Allah.

Nëse ke borxhe, obligime dhe detyrime ndaj të tjerëve, kërko ndihmën e Allahut, thirr: “O Allah”.
Nëse ke problem, nuk gjen njeri që të ndihmon shko te Allahu, mbështetu te Ai, thirr “O Allah”.
Ngrihu natën lutu te Allahut. Ec (lëviz) ditën lutu te Allahu. Kur i ke punët ngushtë lutu. Kur i ke punët mirë lutu. Lutu te Zoti, mos e harro Allahun.

Të nderuar!

Ejubi alejhis-selam është sëmurë, ju lut Allahut, Ai ia pranoi lutjen..
Ibrahimin alejhis-selam e hodhën në zjarr, ju lut Allahut, lutja e tij u pranua..
Jusufi alejhis-selam u burgos, u provokua, ju lut Allahut, lutja e tij u pranua..
Jakubi e humbi Jusufin, ju lut Allahut, lutja ju pranua..
Muhamedi sal-Allahu alejhi ve selem u maltretua, ju lut Allahut, lutja ju pranua.
Nuhi alejhis-selam ju lut Allahut për shpëtim, lutja ju pranua..
Musau alejhis-selam ju lut Allahut për ndihmë, lutja ju pranua..
Sulejmani alejhis-selam lakmoi në të mirat e Zotit, ju lut Allahut, lutja ju pranua..
Zekerijau alejhis-selam u lut për fëmijë, lutja ju pranua..
Ibrahimi alejhis-selam në moshën tetëdhjetë vjeçare ju lut Allahut për fëmijë, lutja e tij u pranua..
Junusi alejhis-selam u lut brenda thellësive të errësirës që të dalë jashtë, lutja ju pranua..
Isau aljehis-selsam kërkoi bereqetin e Zoti, lutja ju pranua..
Muhamedi sal-Allahu alejhi ve selem kërko shefaatin (ndërmjetësimin) për ummetin e vet, lutja ju pranua..

Vallë, a i lutesh Allahut, që të përgjigjet Zoti?!
Ejani, thirrni “O Allah”.

Muhamed Husejn Jakub

Përktheu dhe përshtati: Ulvi F.

Phoca PDF